

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 1

1 E Premte, 10 dhjetor 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.45

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja

6 Sekretare, paraqitni lëndën, ju lutem.

7 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar

8 Gjykatës. Kjo është çështja me numër KSC-BC-2020-07, Prokurori

9 i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirëdita,

11 të gjithëve. Mirë se erdhët.

12 Ka ndryshime në ekipin e Prokurorisë.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

14 Benjamin Dearden, stazhieri nuk është me ne sot, po të tjerët

15 janë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

17 Faleminderit.

18 Zoti Rees.

19 Z. REES: [Përkthim] Nuk ka ndryshim.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti

21 Worboys.

22 Z. WORBOYS: [Përkthim] Nuk ka ndryshim.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti

24 Buckley ndodhet me ne përmes videos.

25 Zoti Buckley, na dëgjoni mirë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 2

1 Z. BUCKLEY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po, mund  
2 t'ju dëgjoj shumë mirë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]  
4 Faleminderit.

5 Vërej për procesverbalin se zoti Gucati dhe zoti  
6 Haradinaj janë të pranishëm në sallë.

7 Tëi kthehem fillimisht kërkesës që ZPS ka dorëzuar dje.  
8 Për dijeni të publikut, do të jap një përmbledhje të  
9 historikut të çështjes.

10 Më 5 nëntor 2021, Trupi Gjykes urdhëroi Mbrojtjen të  
11 bënte të ditur brenda pesë deri tetë ditëve pas zgjidhjes së  
12 të gjitha çështjeve sipas rregullit 102(3), nëse kërkonte t'u  
13 bënte kundërpjetje të mëtejshme dëshmitarëve të ZPS-së.

14 Më 7 dhjetor 2021, Trupi Gjykes mori vendim në lidhje me  
15 çështjen e fundit të pazgjidhur sipas rregullit 102(3).

16 Më 8 dhjetor 2021 Mbrojtja e Gucatit kërkoi rithirrjen e  
17 dëshmitarëve 4841 dhe 4842; që janë, zonja Pumper dhe zoti  
18 Jukiç.

19 Dje, më 9 dhjetor, ZPS dorëzoi një kërkesë në lidhje me  
20 kërkesën e zotit Rees. Parashtrimi i protokolluar i ZPS-së  
21 mban numrin F485.

22 ZPS-ja parashtron se nuk ekziston asnjë bazë për  
23 rithirrjen e dy dëshmitarëve sepse, së pari, nuk ka indicie  
24 nëse ndonjëri prej tyre ka dijeni personale për informacione  
25 nga materialet e rregullit 102(3); dhe, së dyti, në bazë të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 3

1 provave të Mbrojtjes të cilat janë parashtruar dhe dëgjuar,  
2 është konstatuar tashmë se asnjëri prej dy të akuzuarve nuk  
3 është shtyrë në kryerjen e krimit.

4 ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses ose mos lejimin e marrjes  
5 më tej në pyetje të këtyre dëshmitarëve ose rregullimin e  
6 rithirrjes së tyre me kufizimet e mëposhtme që: Së pari,  
7 Mbrojtja të vendos në dispozicion paraprakisht një përmbledhje  
8 të objektit të pyetjeve që do tua bëj këtyre dëshmitarëve dhe  
9 të lidhjes së objektit të synuar me çështjet që ngrihen para  
10 Trupit Gjykses; së dyti, të gjitha provat që kanë të bëjnë me  
11 materialin e rregulli 102(3) të merren në seancë private; dhe,  
12 së treti, të mos lejohen pyetje për asnjë temë tjetër.

13 Pikë së pari, i kërkoj zotit Rees nëse ka ndonjë koment  
14 për këto parashtrime.

15 Z. REES: [Përkthim] Së pari, ne nuk e pranojmë atë që  
16 thuhet këtu nga ZPS-ja se dëshmia e zotit Gucati, nuk e  
17 mbështet pretendimin për shtytje në kryerjen e krimit. ZPS-ja  
18 e ka keqkuptuar në këtë rast sikur shtrëngimi është një  
19 element i domosdoshëm. Nuk është shtrëngimi element i  
20 domosdoshëm për shtytje në kryerjen e krimit.

21 Ne në parashtrimet tona përmbyllëse do ta bëjmë shumë të  
22 qartë që janë të suksesshme pretendimet për shtytje në  
23 kryerjen e krimit. Shtrëngimi nuk është një prej këtyre  
24 elementeve apo të dëshmive.

25 Gjatë gjithë kohës, ne kemi kërkuar që të ecim me

1 shpejtësi dhe e falënderojmë Trupin Gjykses për këtë. Kemi  
2 kërkuar që të mos kemi vonesa por të jemi dhe fleksibël, për  
3 shembull, lidhur me faktin që ZPS-ja nuk i ka përmbushur  
4 plotësisht detyrimet për nxjerrjen që në fillim të këtij  
5 procesi apo në momentin kur përfundimi në mënyrë të rregullt i  
6 dëshmisë nga ana e zonjës Pumper, apo që nuk i kanë kryer  
7 detyrimet për nxjerrjen para përfundimit të dëshmisë të zotit  
8 Jukiç.

9 Ne kemi rezervat dhe shqetësimet tona, ne i kërkojmë  
10 Trupit Gjykses, ta nxisim Trupi Gjykses - më falni - që ta  
11 nxisë më tej procesin, por duke pasur parasysh që Trupi  
12 Gjykses është fleksibël, është i përgatitur për të qenë  
13 fleksibël, ne kemi ndjekur pikërisht këtë mënyrë pune.  
14 Shpresojmë që këtë ta kemi bërë me qëllim që ky proces të  
15 bëhet në mënyrë sa më të shpejtë dhe efikase, pavarësisht nga  
16 vonesat që ka shkaktuar ZPS-ja duke qenë se i kanë keqkuptuar  
17 në mënyrë të përsëritur detyrimet e tyre për nxjerrje dhe ende  
18 nuk i kuptojnë edhe objektin e plotë të pretendimeve për  
19 shtytje në kryerjen e krimit.

20 Për të ndihmuar në këtë aspekt dhe mbështetur në vendimin  
21 e fundit procedural që është marrë nga Trupi Gjykses, këto  
22 materiale na janë nxjerrë vetëm dje - më falni - vetëm pardje,  
23 kërkoj ndjesë. Dhe siç është kërkuar vazhdimisht Trupit  
24 Gjykses është që të kemi këta ne - më falni - e kemi kërkuar  
25 rimarrjen në pyetje të nesërmen e marrjes së vendimit jo për

1 të pritur seri në pesë apo tetë ditë siç thuhej vazhdimisht.  
2 Gjithashtu, ata duhet të jenë në dispozicion, duke qenë se  
3 janë punonjës të ZPS-së, kjo do të na japë mundësinë neve që  
4 të eksplorojmë sa më qartë se ku qëndron pretendimi për  
5 nxitjen në kryerjen e krimit.

6 Kjo reflekton edhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane  
7 për të Drejtat e Njeriut, është thelbësore kur ngrihet  
8 pretendimi për nxitje për kryerjen e krimit Prokuroria të  
9 përmbushë si nxjerrje ashtu edhe të japë, të vendosë në  
10 dispozicion edhe ata dëshmitarë të cilët janë në gjendje të  
11 dëshmojnë për aspektet të cilat kanë lidhje me pretendimin për  
12 nxitje për kryerjen e krimit.

13 Nëse ZPS-ja e përmbush apo jo udhëzimin e Trupit Gjykses  
14 në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, i takon ZPS-së. Sa  
15 i takon vendosjen në dispozicion të këtyre dy dëshmitarëve dhe  
16 sipas kërkesës që Trupi Gjykses na ka bërë neve për të kërkuar  
17 këta dy dëshmitarë, në përputhje me kufizimet e vendosura nga  
18 ZPS-ja sa i takon pistës së nxitjes në kryerjen e krimit, ne  
19 për këtë arsye kërkuam rithirrjen e këtyre dy dëshmitarëve.

20 Mund të jetë kështu siç thotë ZPS-ja, këta dy dëshmitarë  
21 nuk mund të na ndihmojnë në këtë pistë. Ne do ta marrim vesh  
22 të mërkurën kur t'u bëjë unë pyetje. Nëse nuk mund të na  
23 ndihmojnë kështu qoftë dhe ne do bëjmë parashtrimet tona kur  
24 të vijë momenti i duhur por ZPS-ja dhe procesi gjyqësor që  
25 paraqitet përpara Gjykate, nuk na ka dhënë mundësinë që të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 6

1 ngremë siç duhet pretendimin për shtytje në kryerjen e krimit.

2 Nëse mund të na asistojnë apo jo, do ta shikojmë gjatë  
3 pyetjeve që do t'ju bëjmë të mërkurën. Unë synoj që pyetjet që  
4 do tua bëj atyre, të kenë të bëjnë vetëm me çështjet që kanë  
5 dalë nga materialet e nxjerra pas dhënies së dëshmisë së tyre  
6 në sallë. Unë nuk synoj që t'i hyj një rrugë të gjatë për  
7 çështje të tjera që nuk kanë lidhje me këto materiale të  
8 nxjerra.

9 Këto janë parashtrimet tona në këto rrethana, i nderuar  
10 Gjykatës.

11 PËRKTHYESI: Nuk ka mikrofoni Gjykatësi.

12 Z. WORBOYS: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar. Por  
13 mbështes të njëjtin qëndrim të mbajtur nga zoti Rees.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]  
15 Faleminderit.

16 Zoti Halling.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Shumë shkurt, i nderuar Gjykatës.

18 Argumentet që kemi dhënë në parashtrimin e protokolluar  
19 dje, janë argumentet e mbështetura në të drejtën materiale.  
20 Nuk ka asnjë kërkesë të mbetur pa zgjidhur për nxjerrjen në  
21 këtë çështje. Të gjitha janë përmbushur. Kufizimet që përmend  
22 Mbrojtja e zotit Gucati, nuk e dimë se ç'janë, po çfarëdo lloj  
23 kufizimesh të jenë vendosur do jenë vendosur në bazë të  
24 urdhrit që ka dhënë Trupi Gjykses lidhur me kërkesën e ZPS-së.

25 Ajo që dua të përmend tani edhe ta theksoj, ka të bëjë me

1 masën e kërkuar nëse kjo do të ndodhë javën e ardhshme dhe  
2 sidomos, sa i takon zhvillimeve në seancë private për këto  
3 materiale. Ne duam ta ritheksojmë se nuk ka hapësirë për gabim  
4 në këto materiale dhe bërjen e pyetjeve për këto materiale.

5 Këtë javë Trupi Gjykses i ka dhënë urdhër Mbrojtjes së  
6 Gucatit për emrat që kanë përdorur në deklaratën hyrëse. Ka  
7 një parashtrim të protokolluar nga Mbrojtja e Haradinajt që  
8 duhet riklasifikuar sepse emri i një punonjësi, që është  
9 redaktuar vazhdimisht tek parashtrimet tona, është bërë i  
10 ditur në mënyrë të përsëritur, janë bërë 14 redaktime.

11 Këto materiale të rregullit 102(3) janë tejet delikate  
12 për arsye të cilat janë diskutuar gjatë gjithë gjykimit dhe ne  
13 jemi të shqetësuar se mund të ketë keqkuptime retrospektive.  
14 Por mbase këto çështje janë shumë të rëndësishme për ne, për  
15 hetimet të cilat janë duke u zhvilluar, prandaj dhe i kërkojmë  
16 Trupi Gjykses të zbatojë modalitete të cilat ne i kemi  
17 kërkuar.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

19 Faleminderit, zoti Halling.

20 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] I kemi  
22 dëgjuar parashtrimet tuaja. Duam që ta këqyrim këtë çështje më  
23 tej. Gjithsesi duam që vendimin ta nxjerrim sot, kështu që, në  
24 mënyrë që jemi të përgatitur për javën e ardhshme. Shpresojmë  
25 që gjatë pushimit të ardhshëm do të marrim një vendim dhe do

1 të japim urdhër gojarisht lidhur me këtë.

2 Sot jemi të gatshëm të vijojmë me dëshmitarin tjetër që  
3 është me numër 1245, zotin Çelë Gashi. Do të trajtojmë  
4 çështjen e deklaratës së tij, siç kemi vepruar dhe me të  
5 tjerët, duke ndjekur rregullat duke ndjekur hapat e rregullit  
6 154.

7 Z. REES: [Përkthim] Zoti Bowden do të drejtojë marrjen në  
8 pyetje të këtij dëshmitari.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja  
10 Sekretare, ju lutem shoqëroni dëshmitarin për të hyjë në  
11 sallë.

12 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirëdita,  
14 zoti Gashi. Dëgjoni në rregull?

15 DËSHMITARI: Në rregull. Mirëdita.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Asistentja  
17 e sallës së gjyqit do t'ju jap tekstin e deklaratës solemne të  
18 cilën duhet ta -- betim të cilin duhet ta bëni në përputhje me  
19 rregullin 141(2) të Rregullores. Ju lutem, lexojeni me zë  
20 tekstin e deklaratës së betimit solemn.

21 DËSHMITARI: Sipas rregullës 141(2), i ndërgjegjshëm për  
22 rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësisë time ligjore,  
23 deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të  
24 vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë  
25 asgjë për të cilën kam dijeni.

1 DËSHMITARI: ÇELË GASHI

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

3 Faleminderit, zoti Gashi. Uluni ju lutem. Mund ta hiqni  
4 maskën.

5 DËSHMITARI: Faleminderit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Nëse  
7 dëshironi, mund ta hiqni maskën.

8 Zoti Gashi, sot do dëgjojmë dëshminë tuaj. Siç mund ta  
9 dini, zoti Bowden do të flasë fillimisht ai do t'ju bëj pyetje  
10 lidhur me deklaratën tuaj. Pastaj Trupi Gjykues do të japë një  
11 urdhër të shkurtër lidhur me deklaratën. Pas kësaj, pjesa që  
12 do të pranohet nga deklarata do të lexohet për procesverbalin.

13 Pastaj zoti Bowden do t'ju bëjë pyetje të tjera, nëse do  
14 të ketë. Pastaj përfaqësuesit, avokatët e zoti Haradinaj mund  
15 të bëjnë disa pyetje, pastaj rendin do ta ketë Prokuroria për  
16 të bërë pyetje. Si edhe anëtarët e Trupit Gjykues mund t'ju  
17 bëjnë pyetje.

18 Zoti Bowden vlerëson se pyetjet e tij do të jenë të  
19 shkurtra mbase rreth 15 minuta. Prokuroria mendon se do të  
20 bëjë pyetje më gjatë, mendojnë gati dy orë. Trupi Gjykues mund  
21 të lejojë bërjen e pyetjeve plotësuese nga Avokati i Mbrojtjes  
22 nëse përmbushen kushtet.

23 Ju lutem, përgjigjuni pyetjeve qartë me fjali të  
24 shkurtra. Në se nuk e kuptoni një pyetje, lirisht mund t'i  
25 kërkoni personit që jua bën pyetjen ta përsërisë pyetjen dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 10

1 mund të thoni që nuk e kuptoni pyetjen ose mund të kërkonte  
2 sqarim. Gjithashtu, na bëni të ditur mbi ç'bazë i dini faktet  
3 apo rrethanat për të cilat do t'ju bëhen pyetjet.

4 Flisni afër mikrofonit, prisni pesë sekonda përpara se  
5 t'i përgjigjeni pyetjes dhe flisni ngadalë në mënyrë që dhe  
6 përkthyesit të mund t'ju ndjekin.

7 Gjatë dhënies së dëshmisë këtu në Gjykatë, nuk ju lejohet  
8 të diskutoni për dëshminë tuaj, për përmbajtjen e dëshmisë  
9 tuaj me asnjë person tjetër. Nëse dikush jashtë kësaj salle ju  
10 pyet për çfarë keni thënë këtu, na vendosni neve në dijeni.

11 Zoti Bowden, ju lutem pyeteni dëshmitarin fillimisht nëse  
12 deklarata e tij pasqyron me saktësi atë që ai do të thoshte në  
13 Gjykatë, pastaj Trupi Gjykses do të japë urdhër lidhur me  
14 pranueshmërinë e deklaratës.

15 Mund të vazhdoni.

16 Pyetje nga zoti Bowden:

17 Py. Mirëmëngjes, zoti Gashi.

18 Pë. Mirëmëngjes.

19 Py. A mund të konfirmoni emrin, ju lutem.

20 Pë. Çelë Gashi.

21 Py. Datëlindja juaj është 5 prill 1966?

22 Pë. E vërtetë.

23 Z. BOWDEN: [Përkthim] Do të doja që t'i jepnim  
24 dëshmitarit deklaratën e tij.

25 Py. Zoti Gashi, deklarata është e shtypur në të dyja faqet e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 11

1 fletës, pra, në të dyja anët. Janë tre fletë letre.

2 Z. BOWDEN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, vërej se

3 versionet në shqip dhe në anglisht janë në ekran.

4 Py. Zoti Gashi, a na konfirmoni ju lutem që edhe paraprakisht

5 ju është dhënë mundësia që ta lexoni deri në fund këtë

6 deklaratë? Pra, e keni parë përpara këtë deklaratë, e keni

7 lexuar dhe jeni në dijeni të përmbajtjes; kështu?

8 Pë. Po.

9 Py. Tani, ju lutem, kaloni në faqen e fundit që është faqja e

10 fundit, do ta tregojmë dhe në ekran.

11 Pë. Po.

12 Py. Në kopjen që ju keni përpara do të shihni në faqen e

13 fundit një emër, një nënshkrim dhe një datë që thotë 15 korrik

14 2021; kështu?

15 Pë. Po.

16 Py. Ky është nënshkrimi juaj?

17 Pë. Po.

18 Py. Kemi folur së bashku për përmbajtjen e kësaj deklarate

19 dhe a mund të konfirmoni që përmbajtja e kësaj deklarate është

20 e vërtetë.

21 Pë. E vërtetë.

22 Py. Përmbajtja e deklaratës në mënyrë të saktë reflekton ato

23 gjëra të cilat ju do të kishit dashur t'ia thoshit këtij Trupi

24 Gjykues? Kështu është?

25 Pë. Me përjashtim janë dikun, orës dy, tri, katër, kështu ka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 12

1 mundësi me kanë pak gabim. Është dikun.

2 Py. E keni fjalën për paragrafin 2, 3 dhe 4 apo për shkronja  
3 apo për çfarë e keni fjalën?

4 Pë. Jo, është për orën. Thuhet që kam lexuar dy, tri dhe  
5 është katër diku ashtu. S'po kam mundësi 20-30 minuta, 40 jo  
6 dy-tre orë. Ka mundësi që është bë gabim.

7 Py. Ju kuptova.

8 Z. BOWDEN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, bëhet fjalë  
9 për paragrafin 14. I nderuar Gjykatës, qasja që u sugjerua  
10 dje, metoda që u sugjerua dje dhe besoj që për këtë do të  
11 pajtohet dhe ZPS-ja dhe Trupi Gjykues, është që nëse do ta  
12 lexonim këtë deklaratë ka disa paragrafë të cilët nuk do të  
13 lexohen me të cilët ne propozojmë që t'i trajtojmë përmes  
14 dëshmisë së dhënë gojarisht. Kështu që, unë propozoj që të  
15 ndaloj së lexuari në momentin e duhur dhe në atë moment t'i  
16 bëj pyetjen konkrete zoti Gashi, me lejen e Trupit Gjykues, që  
17 të mos t'i lëmë për në fund të deklaratës.

18 Nëse pajtohet Trupi Gjykues me këtë metodë, mbase mund të  
19 ndjek të njëjtën metodë për paragrafin 14, pra, të mos ta  
20 lexoj paragrafin 14 në bazë të kësaj që tha dhe zoti Gashi.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti  
22 Worboys, është e pranueshme kjo për ju?

23 Z. WORBOYS: [Përkthim] Patjetër.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti

25 Halling?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 13

1           Z. HALLING: [Përkthim] Ai tha dy-tre ose katër. Unë  
2 mendoj se duhet të sqarojë dëshmitari çdo pikë të deklaratës  
3 që nuk përputhet me atë që ai mendon se duhet të thënë.  
4 Pastaj, ne mund të themi se cilët dy paragrafë që ne nuk duam  
5 të lexohen.

6           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Përpiquni  
7 të përcaktoni me saktësi se për cilët paragrafë e ka fjalën  
8 dëshmitari.

9           Z. BOWDEN: [Përkthim]  
10 Py. Zoti Gashi, kur përmendët, kur ju pyeta për përmbajtjen e  
11 deklaratës, nëse reflekton me saktësi dëshminë tuaj, përmendët  
12 dy a tre gjëra. Kur thoni dy ose tre gjëra dy ose tre për  
13 çfarë e keni fjalën? Përpara pra ato dy, tre që ju përmendët  
14 apo ka edhe ndonjë gjë tjetër?

15 Pë. Jo, vetëm këto. I kam kaluar dy-tri orë, për shembull 14,  
16 paragrafi 14 është.

17 Py. Pra, ky është.

18 Pë. Edhe është dikund --

19 Py. Ky është i vetmi ndryshim --

20 Pë. Katër jo. Katër orëshi është.

21 Py. -- që dëshironi t'i bëni?

22 Pë. Edhe një -- këtu është dikund. Tash s'po muj me e ditë  
23 ku. Mos ma mbrapa.

24           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sugjerojmë  
25 ta gjejmë që tani.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 14

1 Z. METTRAUX: [Paragrafi] Paragrafi 28.

2 Z. BOWDEN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, me lejen e  
3 Trupit Gjykues, mund të bëj të njëjtin proces edhe për  
4 paragrafin 28 dhe të mos lexoj as paragrafin 28.

5 PËRKTHYESI: Gjykatësi s'ka mikrofoni.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pra,  
7 paragrafët 14 dhe 28 janë dy paragrafët të cilët ka bërë të  
8 ditur dëshmitari se mund të mos jenë të saktë. Sugjeroj që  
9 paragrafi 14 dhe 28 të mos lexohen, po t'i nënshtrohen  
10 pyetjeve nga pala thirrëse dhe kundërpjetjeve.

11 Në rregull, zoti Halling?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Për këto dy paragrafë nuk kemi  
13 problem.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në  
15 rregull.

16 Z. BOWDEN: [Përkthim]

17 Py. Zoti Gashi --

18 Z. BOWDEN: [Përkthim] A më falni. Kërkoj ndjesë, të  
19 nderuar Gjykatës.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

21 Z. BOWDEN: [Përkthim]

22 Py. Zoti Gashi, me këto dy ndryshime që përmendëm, a mund të  
23 thoni atëherë që pjesa tjetër e deklaratës reflekton me saktë  
24 si dëshminë që do të doni t'ia jepni Gjykatës?

25 Ta thoni përgjigjen me zë, zoti Gashi, ju lutem?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 15

1 Pë. Po. Po.

2 Py. Faleminderit.

3 Z. BOWDEN: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, të nderuar  
4 Gjykatës. Kërkesa jonë atëherë është kjo, që të kërkojmë që  
5 kjo deklaratë të pranohet në provat gjyqësore.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Atëherë  
7 kërkesa u bë për t'u pranuar. Argumentimin e kemi bërë dje, në  
8 bazë të këtyre argumenteve Trupi Gjygues e pranon dëshminë e  
9 zotit Gashi në përputhje me Rregulloren me përjashtim të  
10 paragrafëve 16, 32, 34; dhe krahas kësaj edhe paragrafët 14  
11 dhe 28, të cilët i rezervojmë për pyetje nga pala thirrëse.

12 Trupi Gjygues vëren se ZPS-ja kundërshton edhe për  
13 pranueshmërinë në bazë të paragrafit 20 dhe 22, duke  
14 parashtruar se natyra e fakteve që përmenden në këto paragrafë  
15 do të paraqiteshin më mirë nga dëshmia e dhënë gojarisht nga  
16 dëshmitari në sallë. Në bazë të parimit që dëshmia të dëgjohet  
17 në mënyrë gojore.

18 Paragrafi vëren se këta dy paragrafë kanë të bëjnë me  
19 deklaratën e pretenduar të hetuesit të ZPS-së lidhur me qasjen  
20 që Policia e Kosovare ka pasur ose jo në dokumentet e  
21 sekuestruara dhe mundësinë për t'i mbajtur këto dokumente. Në  
22 fakt, rregulla 154 lejon pranimin e deklaratës me shkrim që  
23 përbën provë për veprimet e të akuzuarve nëse përmbushen këto  
24 tre kushte.

25 Rregulli 154 nuk lejon pranimin e dëshmimeve që kanë të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 16

1 bëjmë me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve. Trupi Gjykses e  
2 pranon se ka disa pjesë të caktuara të deklaratës sipas  
3 rregullit 154 që mund të kenë të bëjnë me çështje të cilat  
4 janë kontestuar në veçanti. Pala thirrëse mund ta parashtrojë  
5 për pranim një deklaratë sipas këtij rregulli dhe mund të bëj  
6 edhe pyetje të tjera si palë thirrëse për çdo pjesë të  
7 deklaratës me shkrim.

8 Trupi Gjykses nuk sheh se ka themel për të veçuar  
9 paragrafët 20 dhe 22. Nëse ZPS-ja nuk bindet për përmbajtjen  
10 apo nivelin e hollësive të këtyre paragrafëve mund t'i bëjë  
11 kundërpjetje dëshmitarit.

12 Trupi Gjykses, pra, konstaton se deklarata prefshi edhe  
13 paragrafët 20 dhe 22 dhe 14 dhe 28, ka lidhje me çështjen dhe  
14 ka dhe vlerë provuese duke qenë se flet për veprime dhe  
15 sjelljen e të akuzuarve në lidhje me akuzat e ngritura kundër  
16 tyre.

17 Trupi Gjykses vëren se zoti Gashi është i pranishëm në  
18 sallë dhe është i disponueshëm për kundërpjetje, si edhe për  
19 kundërpjetje nga Prokuroria dhe pyetje nga Trupi Gjykses. Ai  
20 gjithashtu ka vërtetuar se deklarata me shkrim reflekton me  
21 saktësi atë që ai do të thoshte me përjashtim të paragrafëve  
22 14 dhe 28. Prandaj Trupi Gjykses e pranon deklaratën, me  
23 përjashtim të paragrafëve 16, 32, 34; dhe paragrafët 14 dhe  
24 28, si dokument me shkrim, por, sigurisht, atij mund t'i bëhen  
25 kundërpjetje dhe pyetje në këtë sallë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 17

1 Zonja Sekretare, ju lutem caktojini një numër këtij  
2 materiali.

3 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo  
4 deklaratë e dëshmitarit merr numrin 1D9.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] 1D9  
6 pranohet me përjashtimet që unë kam vërejtur.

7 Mund të lexoni deklaratën, zoti Bowden.

8 Siç sugjeruat, mund të bëni pauzë në momentin e duhur dhe  
9 të bëni pyetje për ato paragrafë që nuk do t'i lexoni.

10 Z. BOWDEN: [Përkthim] Deklarata lexon si më poshtë.

11 Unë, Çelë Gashi, do të them si në vijim.

12 Jam lindur në Dobërdol, në komunën e Podujevës, Kosovë.

13 Jam shkolluar në shkollën lokale. Jam shpërngulur në 1983 ose  
14 1984. Tani jetoj në Prishtinë me bashkëshorten dhe me djalin.

15 Në 1983-1984 së bashku me një grup të shokëve jam  
16 përfshirë në mënyrë aktive në promovimin e çështjes së  
17 Kosovës. Në vitin 1985, kushëriri im ishte rekrut jugosllav i  
18 cili u kthye në familjen e tij i vdekur. Ishte në arkivol të  
19 mbyllur. Familjen time e udhëzuan që në asnjë rrethanë nuk  
20 duhej të hapnin arkivolin para varrimit. Ne e injoruar këtë  
21 dhe e hapëm arkivolin për ta parë atë dhe pamë që ishte  
22 qëlluar dy herë me një plagë të vogël hyrëse dhe një plagë të  
23 madhe dalëse. Dukej që ishte që ishte qëlluar nga pas. Ne si  
24 familje mendonim që përgjegjëse ishte ushtria jugosllave.

25 Në mars 1987, më rekrutuan në ushtrinë jugosllave në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 18

1 Vranjë, në Serbinë e ditëve të sotme. Qartazi mendoja që fati  
2 i kushëririt tim më priste edhe mua. Po ashtu isha në dijeni  
3 për rastin e Azis Kelmentit, i cili ishte vrarë. Pas rastit të  
4 tij ushtarët shqiptarë të Kosovës trajtoheshin ndryshe.  
5 Merreshin shpesh në pyetje dhe mendoja që mund të vihesha në  
6 shënjestër në çdo kohë dhe të lëndohesha. Ushtarët shqiptarë  
7 shpesh zgjoheshin dhe merreshin për t'u pyetur nga pjesëtarët  
8 e ushtrisë jugosllave. Krejt çfarë dëshiroja të bëja ishte që  
9 ta përfundoja ushtrinë i palënduar. Trajtimi i ushtarëve  
10 shqiptarë e rriste nivelin tim të ideologjisë për një Kosovë  
11 të pavarur.

12 Në vitin 1988, m'u ofruan 3000 marka gjermane që të  
13 riaktivizohesha dhe të merrja pjesë në luftë. E refuzova këtë  
14 ofertë.

15 Në vitin 1989-1990, Jugosllavia filloi të shpërbëhej. Në  
16 atë kohë punoja në një treg në Prishtinë. Mora pjesë në  
17 protestat e studentëve dhe në grevat që mbaheshin. Në atëkohë  
18 kjo ishte kauza ime e vetme derisa u takova me gruan time të  
19 ardhshme.

20 Në vitet 1990, shqiptarët largoheshin në mënyrë  
21 sistematike nga të gjitha format e punësimit.

22 Më 10 shkurt 1997, për shkak të afërsisë me Sejdi Ramën,  
23 i cili ishte pjesëtar i lartë i UÇK-së, hyra në UÇK. Kam qenë  
24 anëtar aktiv prej atëherë. E bëra betimin me një flamur  
25 shqiptar. Pikërisht në këtë ditë i mora armët për herë të parë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 19

1 dhe u armatosa.

2 Ne konsideroheshim si çlirimtarë nga serbët të cilët u  
3 bënë shtypësit tanë. Kisha shumë konflikte dhe probleme me  
4 policinë serbe. Ishim në përcjellje të vazhdueshme nga serbët  
5 dhe kishin frikë të vazhdueshme nga arrestimi dhe likujdimi.

6 Në fillim të vitit 2017, u bëra anëtar i kryesisë së  
7 këshillit drejtues, 61 anëtarë nga të gjitha komunat dhe  
8 anëtar i kryesisë, rrethi i brendshëm prej 23 anëtarëve. Në  
9 atë kohë, u bëra bashkëpunëtor i ngushtë i Hysni Gucatit kur  
10 sapo ishte zgjedhur kryetar i Organizatës së Veteranëve të  
11 Luftës Çlirimtare të Kosovës, OVL UÇK. Dega ime e OVL-së ja  
12 dha votën unanime Hysni Gucatit.

13 Më 7 shtator 2020 rreth afërsisht orës 10.00, unë isha me  
14 Hysni Gucatin, Nasim Haradinajn, Faton Klinakun, Taibe  
15 Miftarin dhe Elvir Gucatin në zyrat e OVL-së lart.

16 Taibe Miftari ishte shumë e shqetësuar, meqë një pako  
17 ishte sjellë dhe ajo mendonte se mund të ishte bombë. Ajo na  
18 tha të gjithëve që ishte sjellë një paketë, por ajo dukej  
19 shumë e shqetësuar, kështu që të gjithë dolëm nga zyra ku  
20 ishim për të parë se çfarë ndodhte.

21 Skena ishte shumë hutuese. Disa thonin që paketa ishte  
22 bombë dhe kjo shkaktonte panik. Megjithatë, kur Nasimi shkoi  
23 të shikonte, ne kuptuam që në paketë kishte vetëm letra. Sapo  
24 e kuptuam një gjë të tillë situata u qetësua. Shkova në  
25 recepsion ku pashë një paketë, pak më të vogël se paketa e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 20

1 bananeve, në të cilën gjendeshin dokumente. Këto dokumente  
2 kishin shkrim në gjuhën serbe përfshirë emra serbë, si  
3 Vukçeviç. Nuk e njihja këtë emër. Megjithatë, e kam parë këtë  
4 emër shumë herë sepse ishte përmendur në shumë dokumente.

5 Të nderuar Gjykatës, nuk e di në qoftë se mund të ndaloj  
6 së lexuari deri tani.

7 Py. Zoti Gashi, a është e vërtetë që deri në këtë moment ju  
8 ishit nën shoqërinë e zotit Gucati, Haradinaj dhe zotit  
9 Klinaku?

10 Pë. Po e vërtetë.

11 Py. Dhe kishit këtë paketën me letra me vete?

12 Pë. Po.

13 Py. Dhe po diskutonit dhe po shihnit përmbajtjen e këtyre  
14 letrave?

15 Pë. Po.

16 Py. Ju vetë keni lexuar disa prej këtyre dokumenteve; a është  
17 e vërtetë kjo?

18 Pë. Po, e vërtetë.

19 Py. A mund të jepni një vlerësim të përafërt se sa dokumente  
20 keni lexuar dhe sa kohë të është dashur për t'i lexuar ato  
21 dokumente?

22 Pë. Nuk i kam lexuar të gjitha, po muj me thënë kam lexuar  
23 disa. Se ka pasë -- goxha numër voluminoz janë kanë ato.

24 Py. Kur thua "disa" a mund të na japësh një shifër pak më të  
25 saktë? Ndoshta 5, 10, 20?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 21

1 Pë. 70, 100 po them, përafërsisht.

2 Py. Dhe sa kohë t'u desh? Sa kohë morët për t'i parë këto  
3 dokumente?

4 Pë. Ka mujt me kanë pjesë-pjesë. Ka dalë dhe jam kthyer  
5 kështu a din, se mu ka du me shku pak edhe te Taibja me këqyrë  
6 pak gjendjen gjysh e ka se ajo qe shumë e frikësuar.

7 Py. Pra, nuk është se ishte një periudhë kohe e pandërprerë?

8 Pë. Jo, s'a kanë.

9 Py. Po ishin periudha më të shkurtra? Po t'i marrësh bashkë  
10 të gjitha këto kohët e ndërprera sa kohë bëhet pak a shumë?

11 Pra, në qoftë se këto fragmente kohe i bashkon me njëra-  
12 tjetrën pak a shumë sa kohë?

13 Pë. 30-40 minuta përpjetë, përafërsisht s'po muj me i ditë  
14 saktë. Po ka muj me kanë se një pjesë ndamë a kanë.

15 Py. Pra, 30-40 minuta gjithsej; kështu?

16 Pë. Ka mundësi po them. Po s'jam fortë i saktë, se është kohë  
17 pak e gjatë, po përafërsisht ka mujt me kanë.

18 Py. Sigurisht. Faleminderit, zoti Gashi.

19 Z. BOWDEN: [Përkthim] Atëherë do të vazhdoj që të lexoj.  
20 Mundem, të nderuar Gjykatës?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po.

22 Z. BOWDEN: [Përkthim] Deklarata vijon si më poshtë.

23 Duke e shikuar paketën me dokumente, mendova me vetvete  
24 sesi ka mundur ZPS-ja të bie në nivelin e Serbisë. Isha i  
25 hutuar lidhur me qëllimin e arsyes pse ishin sjellë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 22

1 dokumentet. Ne menduam që publiku kosovar duhet të informohej  
2 lidhur me përmbajtjen e paketës, meqë kjo do të minonte Dhomat  
3 e Specializuar të Kosovës, DHSK, i cili është organ që nuk e  
4 njohim si legjitim. Ne nuk kemi dashur të japim emra. Vetëm  
5 kemi dashur t'i tregojmë publikut që Serbia ja ka dhënë  
6 informatat Hagës.

7 Më 8 shtator 2020, të nesërmen, rreth afërsisht orës  
8 11.00 isha duke pirë kafe me miq për jo në selinë e OVL-së. E  
9 mora një telefonatë për t'u kthyer në zyrë, por nuk e dija  
10 arsyen pse.

11 Kur u ktheva, i pashë katër të huaj në seli. E kuptova që  
12 dy prej tyre ishin nga Haga dhe ata ishin të shoqëruar nga dy  
13 përkthyes, një mashkull dhe një femër. Dy përkthyesit u  
14 prezantuan dhe thanë se ishin nga Haga. Pren Marashi, kryetari  
15 i degës së OVL-së, ishte i pranishëm aty.

16 Njëri nga personat nga Haga ishte suedez, por dukej si  
17 kinez dhe ishte ulur. Tjetri dukej pak i tendosur, i trazuar,  
18 i shqetësuar dhe nuk pranoi të ulej. Unë isha ulur përballë  
19 dhe mund ta shihja që ai ishte dukshëm nervoz. Personi që  
20 qëndronte në këmbë ishte konfrontues. Faton Klinaku ishte i  
21 pranishëm dhe insistoi që personi të ulej. Personi tha që po  
22 ofronte siguri. Në anën tjetër, Fatoni u përgjigj duke thënë  
23 që ai nuk mund të ofronte siguri në zyrën tonë. Në fund,  
24 pastaj personi u ul dhe situata u qetësua. Të dytë pastaj pinë  
25 kafe me ne.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 23

1           Personat kërkonin që ne t'iu jepnim dokumentet. Ne ju  
2 thoshim personave që nuk do t'u jepnim dokumentet deri sa të  
3 flisnim me një prokuror të Kosovës. Pasi të flisnim me të  
4 atëherë do të vendosnim se çfarë të bënim më tej. Ata vazhduan  
5 t'i kërkonin dokumentet dhe ne vazhdimisht ua mohonim qasjen.  
6 Hetuesi suedez i ZPS-së pastaj tha: "Mund të rrimë këtu një  
7 muaj por askush nga Prokuroria e Kosovës apo policia vendase  
8 nuk do të vijë pa aprovimin tonë".

9           Në këtë kohë, kur hetuesit e ZPS-së ishin të pranishëm, i  
10 thashë Fatonit që ata duhet të shikojnë filmimet e CCTV të  
11 kamerave për të identifikuar personat që i kishin sjellë  
12 dokumentet. Pastaj i telefonuam Hysni Gucatit, i cili ishte në  
13 Shqipëri në atë kohë, i cili tha që duhej t'ua jepnim atyre  
14 filmimin e CCTV-së.

15           Pastaj ata thanë që mund t'i mbani dokumentet një muaj  
16 dhe pastaj u përmend që prokurori kosovar mund të lejohej që  
17 të kishte qasje në dokumente atëherë.

18           Ose më 14 ose më 15 shtator 2020, ne, në OVL, vendosëm që  
19 çdo sjellje dokumenteve të kësaj natyre do të bënim publike  
20 menjëherë. Sa jam në dijeni, ne kemi postuar gjëra në Facebook  
21 për të konfirmuar këtë politikë. Duke qenë kështu, gazetarët  
22 do të ftoheshin përmes emailit që të merrnin pjesë në  
23 konferencat për shtyp në të ardhmen.

24           Më 16 shtator 2020, unë isha në zyrat e OVL-së me Taibe  
25 Miftarin dhe Elvir Gucatin. Isha ulur në zyrë me derë të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 24

1 hapur. Isha në dijeni që një person hyri në zyra dhe u shfaq  
2 në derë. Dukej i hutuar dhe i frustruar. Isha i pari që u mora  
3 me personin e panjohur, sepse Taibja ishte femër kështu që nuk  
4 doja që ajo të ballafaqohej me të. Taibja ishte hutuar dhe  
5 frikësuar dhe isha i shqetësuar për mirëqenien e saj. Qëllimi  
6 im ishte që të mos e lejoja të hynte në zyrat tona. Personi  
7 endej poshtë e lartë nga restoranti tek hyrja ku gjenden zyrat  
8 tona. Doja ta pengoja që të mos hynte në zyrat tona.

9 Personi i panjohur, hyri brenda duke e bartur një paketë  
10 të madhe, të cilën e lëshoi në dysheme. Kur dola të merrem me  
11 personin, unë isha më afër personit sesa vetë paketa. Nuk kam  
12 folur me personin. Pasi që e lëshoi paketën në dysheme,  
13 personi u largua nëpërmjet derës së njëjtë dhe dukej i hutuar  
14 sa i përket vendndodhjes së daljes.

15 Personi ishte i maskuar, mbante doreza dhe ishte i tëri i  
16 veshur me rroba të zeza. Ishte e pamundur të dalloje ndonjë  
17 karakteristikë identifikuese.

18 Personi pastaj shkon në drejtim të shkallëve dhe u zhduk.  
19 Fatoni e ndoqi nga pas edhe unë shkova pas Fatonit, meqë  
20 frikësohesha për mirëqenien e Fatonit. Megjithatë, personi  
21 ishte shumë i shpejtë dhe doli nga ndërtesa. Ne e ndoqëm pas  
22 një kati po ishte shumë më i shpejtë sesa ne. Nuk e kemi  
23 përcjellë deri poshtë në katin përdhes. Në të vërtetë, kur u  
24 kthyem në zyrën tonë, të gjithë thanë se nuk ishte dashur fare  
25 të rrezikonim veten duke e ndjekur atë. Fatoni dhe unë shkuam

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 25

1 të shikonim nga dritarja por nuk mund të shihnim në cilin  
2 drejtim shkoi personi.

3 Edhe njëherë, të nderuar Gjykatës, a mund të bëj një  
4 pauzë në këtë moment dhe të qartësoj disa gjëra me zotërinë?

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po.

6 Z. BOWDEN: [Përkthim] Zoti Gashi, në këtë fazë ju ishit  
7 në shoqërinë e zotit Gucati, Zotit Haradinaj dhe zotit  
8 Klinaku; a është e saktë kjo?

9 Pë. E saktë.

10 Py. Dhe paketa me letra që ishte sjellë nga ky personi që nuk  
11 njihej, u mor dhe u dërgua në zyrën e Hysni Gucatit; a është e  
12 saktë kjo?

13 Pë. Po.

14 Py. Dhe juve i patë këto dokumente; a është e saktë kjo?

15 Pë. Po.

16 Py. Si dërgesat e mëparshme, a të kujtohet se sa dokumente ke  
17 parë ti vetë personalisht?

18 Pë. Nuk muj me thënë, se Taibja a kanë goxha shumë e stesume  
19 dhe kam shku aty me të jam marrë me qetësue. Se gjithmonë,  
20 jena kanë më shumë, jena interesu për çështjen e saj, sesa kur  
21 që erdhën ajo që ma e stesume dhe na u deshtë me shku me i  
22 dhanë kuraju edhe me i thënë që të jetë më e qetë edhe me qit  
23 ujë, me dhënë me pi kështu.

24 Py. Pra, edhe njëherë ju nuk është se keni shpenzuar një kohë  
25 të pandërprerë --

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 26

1 Pë. Po.

2 Py. -- për të parë dokumentet; a është ky qëndrimi juaj? Këtë  
3 po thoni? A mund të na jepni në vlerësim të përgjithshëm se  
4 cila është koha e përgjithshme që keni shpenzuar duke parë  
5 dokumentet?

6 Pë. Në përgjithësi veç ato. A në përgjithësi sa herë janë  
7 ardhë apo veç ato në q'atë kohën sa kanë ardhë?

8 Py. Jo, e kemi fjalën për këtë rast specifik, për këtë rast  
9 konkret.

10 Pë. Ka mundësi 10, 15, 20 minuta. Tash s'po muj se ajo koha  
11 është ka kenë e limitume me mujt me këqyrë.

12 Py. Dhe nuk të kujtohet sa dokumente ke parë apo jo?

13 Pë. Veç e di - s'di a kam drejtë me folë? Ajo është për --

14 Py. Sigurisht.

15 Pë. -- për Vukçeviçin po që janë bë. Këtu e kam lexu emrin e  
16 tina dhe në gjuhën serbe nuk e njoh fort mirë veç për afërsisht  
17 e njoh dhe kam lexu disa letra kështu kredenciale që janë bë  
18 përmes Vukçeviçit dhe SPO.

19 Py. Faleminderit.

20 Z. BOWDEN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të  
21 vijoj me leximin e pjesës së mbetur të deklaratës?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po.

23 Z. BOWDEN: [Përkthim] Deklarata vijon si më poshtë.

24 Tashmë e kishim marrë një vendim kolektiv ose më 14 ose  
25 më 15 shtator, që nëse ndodhte të sillnin dokumente të tjera

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Bowden

Faqe 27

1 do të thërritej një konferencë për shtyp dhe do të informohej  
2 publiku lidhur me përmbajtjen e paketës dhe të dokumenteve.  
3 Kështu edhe vepruam.

4 Më 22 shtator 2020, së bashku me Emin Latin, ishim në  
5 sallën e konferencave në katin e sipërm të ndërtesës së OVL-  
6 së, kur e dëgjova një rrëmuje poshtë në zyrat e OVL-së. Shkova  
7 poshtë dhe e pashë që Taibja ishte e shqetësuar, kështu që u  
8 përpoqa që ta qetësojë atë. Ajo më tha dhe tani e di që një  
9 mashkull kishte hyrë në zyrë dhe i kishte sjellë dokumente të  
10 cilat i kishte hedhur në dysheme.

11 I shikova shpejtë dokumentet, të cilat duket se ishin  
12 aktakuza dhe ishin në gjuhën angleze. I njihja emrat te  
13 aktakuza dhe u trondita sepse ata ishin heronjtë e mi dhe  
14 vetëmohues për çështjen. E dija që kjo ishte vepër e Serbisë.

15 Pas burgimit të Hysni Gucatit, rreth përfaqësimit mesit  
16 të majit 2021, i kam parë prindërit e tij të vjetër ndërsa  
17 ishin në muze dhe më erdhi keq për ta.

18 Jam i gatshëm të vij dhe të dëshmojë në DHSK në Hagë.

19 Ky është fundi i deklaratës tuaj.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Keni  
21 ndonjë gjë tjetër sa i takon dëshmitarit?

22 Z. BOWDEN: [Përkthim] Jo.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti  
24 Worboys, keni ndonjë pyetje.

25 Z. WORBOYS: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë. Faleminderit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 28

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti

2 Halling.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

4 Pyetje të palës tjetër nga zoti Halling:

5 Py. Mirëmëngjes, zoti Gashi. Unë jam Matt Halling dhe jam

6 Prokuror i Asociuar me ZPS-në. Dhe do t'ju bëj disa pyetje sot

7 në mëngjes.

8 Deklarata e cila u lexua tani, është një deklaratë të

9 cilën juve e keni nënshkruar më 15 korrik 2021; apo jo?

10 Pë. Po.

11 Py. Dhe në këtë deklaratë që ju keni nënshkruar, në

12 paragrafin 14, ju keni thënë që keni shpenzuar dy deri në tre

13 orë për të rishikuar paketën me materiale që ishte dërguar në

14 OVL të UÇK-së; a është kështu?

15 Pë. Kam mundësi që është bërë gabim këtu në përkthim.

16 Py. Deklarata që ju keni nënshkruar më 15 korrik është në

17 gjuhën shqipe; apo jo?

18 Py. Po.

19 Py. A e flisni gjuhën shqipe?

20 Pë. Po.

21 Py. A e patë për së dyti edhe njëherë, pra, deklaratën

22 përpara sesa ta nënshkruanit?

23 Pë. Po, e kam pa këtu.

24 Py. Në paragrafin 28 të deklaratës që keni nënshkruar, ju

25 thoni që i keni parë dokumentet në paketën e dytë për deri në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 29

1 katër orë; a është kështu?

2 Pë. Përafërsisht në të dyja t'u bë gabim ora. Sepse s'ka  
3 pasur mundësime me katër orë se a kanë kohë e shkurtë ajo. Se  
4 katër orë s'ka muj me ndodhë as ajo. Kur janë thirrë mediat  
5 ajo a kanë një orë. Krejt a kanë një orë. S'kam mujtë unë me  
6 pasë qasje më shumë. Për sa kjo e vërteton.

7 Py. Më 6 shtator 2021, ju keni nënshkruar përkthimin në  
8 anglisht të njëjtës deklaratë; a është e saktë kjo?

9 Pë. Po.

10 Py. A e flisni gjuhën angleze?

11 Pë. Jo.

12 Py. Po deklarata a ju lexua përsëri mbrapsht juve përpara  
13 sesa ta nënshkruanit atë?

14 Pë. Mu ka lexu. Po kjo a kanë send se kur erdha këtu për sa  
15 të thashë t'i përmirësue. Plus edhe në fillim pak, po unë  
16 s'deshta me ndërhy, se shkolla është ajo në Kërpemeh po unë  
17 s'deshta me hi më detale, fillimisht kur a kanë. Janë bë disa  
18 lëshime të vogla.

19 Py. A ke bërë ndonjë korigjim në deklaratën e datës 6  
20 shtator 2021, përpara se ta nënshkruanit, domethënë, në  
21 momentit që u lexua?

22 Pë. Kam bë po. Po qetu unë kur jam ardhë e kam marrë e kam  
23 lexu dje, i kam vërejtë kështu gabimet që janë bë.

24 Py. Kush ta lexoi mbrapsht deklaratën më 6 shtator?

25 Pë. E kam lexu vetë. Besoj se vetë e kam lexu. S'ka pasë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 30

1 mbrapshtë me ma lexu kërrkush. Unë s'thashë unë me ardhë këtu.

2 E kam përcjellë edhe pashë që janë do gabime teknike.

3 Py. Zoti Gashi, tani po flas për versionin në anglisht të  
4 deklaratës tuaj. Ju thatë që përpara sesa ta nënshkruanit këtë  
5 deklaratë dikush jua lexoj përsëri deklaratën. Pyetja ime  
6 është kjo: Kush ta lexoj përsëri deklaratën përpara se ta  
7 nënshkruanit?

8 Pë. A është kanë Admiri, kur kena ardhë se na ka përkthi se  
9 unë s'kam ditë anglisht.

10 Py. A i thatë Admiri juve që të bënte ndonjë korrigjim në  
11 këtë moment?

12 Pë. Dy herë kam bë korrigjim, se përkthimi a kanë pak më i  
13 dobët. Edhe herën e parë edhe në të dytën a kanë. Nuk e kam  
14 fjalë fort adekuate që janë shkruar. Që dhe tash po dikun ka  
15 pak gabime kështu në përkthim.

16 Py. Pra, a e kam të saktë unë këtë gjë që këto dy gabimet që  
17 identifikuat sot janë dy gabime që i keni identifikuar edhe me  
18 Admirin më datë 6 shtator 2021?

19 Pë. Jo, jo tash. Tash. Tashi mo.

20 Py. E kam fjalën për datën 6 shtator 2021. Pyetja ime është:  
21 Atë ditë ju a i keni komunikuar të njëjtat korrigjime që na  
22 thatë në Gjykatë sot?

23 Pë. Disa i kemi bë. Po këtu jo. S'janë kanë. Po tash kam  
24 kuptue, i kam pa. Se dhe, më fal, se unë dy vite i kam krye në  
25 Kërpimeh është fshati, këtu nuk është i cekun hiç. Kur e kam

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 31

1 kry shkollën. Shkolla e mesme, dy në Kërpimëh, dy në Podujevë  
2 janë. Është. Ndoshta unë thashë a bën me bë, me i rregullu  
3 këto. Fillimisht kështu. Shkon fillimisht e sheh.

4 Py. Përmbledhja që sapo jua lexoi zoti Bowden, rreth viteve  
5 tuaja në shkollë, a ishte e saktë?

6 Pë. E saktë, po shkolla ku e kam krye se janë dy paralele a  
7 kanë e ndamë në Podujevë dhe në Kërpimëh. Paralelin e parë dy  
8 vjet, viti i parë dhe i dytë u bë në Kërpimëh. Kurse i treti  
9 dhe i katërti u bë në Podujevë. Është shpërngulja që  
10 shkruante, shpërngulja. Është shpërngulja që shkruante,  
11 shpërngulja që thotë. Dhe aty është ajo. Ça thojnë gabim është  
12 se dy vjet i kam krye shkollës së mesme në Kërpimëh, dy në  
13 Podujevë.

14 Py. Pra, paragrafi 1 që sapo ju lexua juve këtu; a është i  
15 saktë apo jo? Mënyra se si jua lexoi këtë paragraf, zoti  
16 Bowden?

17 Pë. Dy qe. Mundesh pak. Qe.

18 A bën me lexu, më fal. A bën me e lexu?

19 Po.

20 Py. Po, po.

21 Pë. Jam lindur në Dobërdol në komunën e Podujevës, Kosovë.

22 Jam shkolluar në shkollën lokale. Shkolla lokale është këtu në  
23 fshat në Dobërdol. Jam shpërngulur 1983-1984. Kjo jam  
24 shpërngulur nuk po është -- shkollën dy vjet këtu. Këto dy  
25 vite në Kërpimëh, në shkollën e mesme dy vjet. Më vonë në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 32

1 Podujevë dy vjet. Katër vjet është. Kështu u bo s'u shkru hiç  
2 këto shkollimet.

3 Py. Dhe e keni nxjerrë këtë, e keni ngritur këtë si shqetësim  
4 edhe më datë 6 shtator 2021? E keni thënë këtë?

5 Pë. Po e kam thënë, po s'ka mujt -- s'u vendosë a ku me ditë  
6 që ça u bë gabim. S'po dinë unë ça u bë gabim. Se unë e kam  
7 caktu, e kam thënë që q'ashtu është, se unë shkollën e kam  
8 krye qatje s'muj me thënë që kam krye dikund tjetër kur e kam  
9 kry qatu.

10 Py. A të është dhënë ndonjëherë një version i ndryshuar i  
11 deklaratës së 15 korrikut që reflektonte këto ndryshimet që  
12 thatë?

13 Pë. Më herët a kanë -- ka pasë diçka po jo shumë këtu. E  
14 kështu që kjo është gabimi për shkollë edhe për siç është  
15 shkry, i pari është. Versioni i parë është ajo.

16 Py. Komentet që dhatë ju lidhur me kohën që keni përdorur për  
17 të parë paketën e parë dhe paketën e dytë, pra, informacioni  
18 që ndodhesh në këto paketa --

19 Pë. Po.

20 Py. -- a tregojmë këto korigjime që keni bërë juve me datë -  
21 - kanë qenë pjesë e korigjimeve që keni bërë më datë 6  
22 shtator?

23 Pë. Kanë qenë të gjitha. Të gjitha janë kanë kështu. Po tash  
24 qysh a ardhë nuk po muj me ditë nga këto. Se unë e kam mbaru  
25 shkollën Kërpemeh krejt. Ça u bë gabim nuk muj me ditë. Se unë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 33

1 s'kam mujt me mohu shkollën që jam kanë, për shembull, se ato  
2 vite që kam krye dhe po del se unë jam veç shkollën fillore  
3 dhe kurrëgjë hiç.

4 Py. Zoti Gashi --

5 Pë. Po.

6 Py. -- kur t'u lexua më 6 shtator 2021, ky citim "që kam  
7 shpenzuar dy ose tre orë duke rishikuar dokumentet", a i  
8 informove anëtarët e Mbrojtjes me të cilët po flisje që kjo  
9 pjesë ishte e pasaktë?

10 Pë. Unë në q'atë kohë -- ne kena thënë, po tash s'po më  
11 kujtohet.

12 Py. A të është dhënë ndonjëherë një version i ndryshuar i  
13 deklaratës së 15 korrikut 2021 --

14 Pë. M'u ka dhënë anglisht.

15 Py. -- me ndryshimin e këtij fakti në shqip?

16 Pë. Në fund mu ka dhënë anglisht.

17 Py. Pra, deklarata juaj e datës 15 korrik 2021 nuk është  
18 ndryshuar asnjëherë pasi ju e keni nënshkruar atë; a është e  
19 saktë kjo?

20 Pë. Jo. Mbasi që të thashë që e kam nënshkruar jo.

21 Py. Dhe kur i njëjti anëtar i Mbrojtjes ju lexoi nga  
22 paragrafi 28 dhe "ne i kaluam dokumentet, megjithëse jo të  
23 gjitha ato, deri në katër orë" a i thatë këtij anëtari që  
24 duhet bërë një korigjim lidhur me këtë fragment më datën 6  
25 shtator 2021?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 34

1 Pë. Nuk më kujtohet ta kem thënë. S'muj me thënë. Veç këtu  
2 kur erdha e pashë këto gabime që ishin kanë edhe unë këtu i  
3 shtova këto. Veç si doni bëni ju. S'është problem hiç.

4 Py. Ju keni bërë një seancë përgatitore me Mbrojtjen e zotit  
5 Gucati këtë javë, a është e saktë kjo?

6 Pë. Jo, jam takue -- kjo ë? Këtu?

7 Py. Kësaj jave?

8 Pë. Po.

9 Py. Këtë javë.

10 Pë. Po.

11 Py. Më 7 dhjetor; a është e drejtë kjo? Është e saktë?

12 A i rishikuat deklaratat tuaja në këtë seancë përgatitore?

13 Pë. Jo, s'e kam këqyrë këtë unë. Se shkurt kanë nejt këta.  
14 Pesë minuta s'kanë nejt.

15 Py. A i ke këqyrë deklaratat e tua përpara kësaj seance  
16 përgatitore?

17 Pë. Si të thashë unë se dy ditë i kam pa këto i këqyra. Kur i  
18 pashë e pashë që ka gabime.

19 Py. Kur i ke parë përpara seancës përgatitore?

20 Pë. Dje, pardje i kam pa këto. S'po di tash. Dje a pardje i  
21 lexova i pashë si nuk është shkollimi, as këto gabimet që janë  
22 bë.

23 Py. Zoti Gashi, dua t'ju lexoj një pjesë të një emaili nga  
24 Mbrojtja e Gucatit. Ky email është dërguar më datë 7 dhjetor  
25 2021 në orën 08.14 dhe ka lidhje me këtë seancë përgatitore.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 35

1 Unë thashë që seanca ishte më datë 7 dhjetor por, në fakt,  
2 emaili thotë që ka qenë në mbrëmjen e datës 6 dhjetor. Ju  
3 lutem, më dëgjoni me vëmendje çfarë do të lexoj dhe pastaj kam  
4 disa pyetje.

5 "Ditën e hënë, më datë 6 dhjetor 2021, Huw Bowden,  
6 Bashkëmbrojtësi, Eleanor Stepheson, Bashkëmbrojtëse dhe  
7 Muharrem Halilaj, anëtar i ekipit zhvilluan seancën  
8 përgatitore me dëshmitarin DW1245, Çelë Gashi në mjedise e  
9 Dhomave të Specializuara të Kosovës, në Hagë, nga ora 07.25  
10 deri në orën 07.45.

11 "Deklarata e dëshmitarit DW1245, që mban numrin DHG0190  
12 deri në DHG0194 është nxjerrë zyrtarisht si pjesë paketës 64  
13 në përputhje me udhëzimet që Trupi Gjykues i ka dhënë për  
14 pranimin e materialeve në përputhje me rregullin 154, me  
15 sqarimin dhe me korrigjimet e mëposhtme të nevojshme.

16 "Dëshmitari konfirmoi se përmbajtja e deklaratës së tij  
17 është e saktë dhe s'ka nevojë që të bëhet asnjë ndryshim i  
18 deklaratës".

19 Zoti Gashi, kështu keni thënë ju gjatë seancës  
20 përgatitore, këtë gjë?

21 Pë. Unë siç e kam thënë, po unë kur erdha pashë këtu. E pashë  
22 me gabime kur erdha, kur dje a pardje, po është me gabime.

23 Py. Këto gabime ja bëtë të ditur Mbrojtjes së Gucatit gjatë  
24 seancës përgatitore?

25 Pë. Fillimisht janë kanë gabime edhe ma të mëdha. Kur u bë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 36

1 hera e parë se e kam korrigju edhe dy-tri herë këto janë  
2 korrigju. Po gabime ka pasë teknike shumë. Gjithmonë ka pasë  
3 gabime.  
4 Py. Zoti Gashi, a nuk është e vërtetë se ky vlerësim për dy  
5 deri në tre orë ju e keni dhënë në korrik, në shtator edhe në  
6 6 dhjetor, pra, e kam fjalën dy deri në tre orë për të parë  
7 materialet e paketës së parë është, në fakt, se kështu e mbani  
8 mend se aq orë i keni kaluar?

9 Pë. Unë nuk po të them për herën e dytë, se katër orë s'ka  
10 pasë mundësi. Se ato hera e dytë është kanë krejt një orë, një  
11 orë e gjysë që i kemi thirrë dhe mediat e janë ardhë. E këtu  
12 thotë katër orë. Ajo katër orë janë kanë mediat, janë kanë  
13 krejt, s'ka pasë mundësi unë me i lexu gjithë ato. Për qëta  
14 unë binda në ato, të dytën katër orë.

15 Py. Pyetjen e bëra në lidhje me paketën e parë. Po e përsëris  
16 edhe njëherë.

17 Pë. Po.

18 Py. Zoti Gashi, a nuk është e vërtetë që ky vlerësim "dy deri  
19 në tre orë" që e ke bërë ti dhe e ke dhënë në korrik, në  
20 shtator dhe në 6 dhjetor, lidhur me shqyrtimin që i keni bërë  
21 paketës së parë të materialeve, në të vërtetë është ajo siç ju  
22 kujtohet juve se aq kohë ju është dashur ose aq kohë keni  
23 kaluar për shqyrtimin e asaj pakete? Ju lutem, kësaj pyetjeje  
24 t'i përgjigjeni.

25 Pë. S'ka muj me kanë aq shumë s'besoj kurrë se ka -- se dy

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 37

1 orë është punë e madhe me lexu se kemi pasë edhe tjera punë  
2 aty teknike, sende, për qëta s'besoj që ka mujtë me kanë aq  
3 shumë.

4 Py. Në lidhje me paketën e dytë tani. Sapo thatë se mbase ka  
5 qenë një orë a një orë e gjysëm që keni kaluar duke i  
6 shqyrtuar materialet. Pak ma herët sot thatë 10, 15, 20  
7 minuta. Tani cila?

8 Pë. Nuk thashë ashtu unë. Më fal. Unë thashë një orë e gjysë  
9 janë ardhë mediat dhe s'kemi pasë kohë ne me i bë katër orë.  
10 Aty shkrun katër orë. A shkrun? Dhe një orë e gjysëm gati janë  
11 ardhë mediat dhe janë ardhë ato dhe s'kam mujtë me i lexu më  
12 kur janë ardhë mediat dhe kur asi.

13 Unë mes tyne po bindna se s'ka mundësi katër orë, s'ka  
14 pasë kurrë qysh. Jo dhe jo. Vetë shiqoje, vetë këqyre.

15 Py. Zoti Gashi, tani, në këtë moment, sipas vlerësimit tuaj,  
16 siç e mbani mend sa kohë keni kaluar me shqyrtimin e paketës  
17 së dytë të materialeve?

18 Pë. 20-30 minuta. S'ka pasë mundësi më shumë. Edhe ato nuk  
19 janë krejt për menjëherë po ndërkohë kështu sa kam pasur  
20 mundësi.

21 Py. A mund të na shpjegoni pse herën e parë këto numra janë  
22 paraqitur si dëshmi - më falni - pse është hera e parë - ta  
23 riformuloj pyetjen - Pse është hera e parë sot, paradite, që  
24 po e thoni këtë vlerësim kohor?

25 Pë. Se sot e kam pasë mundësinë me u taku me juve.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 38

1 Py. Pra, këto korigjime i dhatë sot në mëngjes, ngaqë po

2 flisnit me mua tani? Kjo është përgjigja juaj?

3 Pë. Po, po.

4 Py. Zoti Gashi, sot në mëngjes thatë se shqyrtuat diku nga 70

5 deri në 100 dokumente kur morët paketën e dytë; kështu?

6 Pë. Po, i kam shfletu edhe që i kam këqyrë.

7 Py. Kërkoj ndjesë. Pra, 70 deri 100 dokumente kur i

8 përmendët, i përmendët në lidhje me paketën e parë a me

9 paketën e dytë që i shqyrtuat?

10 Pë. Nuk muj, s'po di a në të parën ose në të dytën ka mundësi

11 mos në dytën mos a kanë. Nuk po muj s'jam i sigurtë. Në të

12 dytën mos a kanë.

13 Py. A mund të na shpjegoni pse nuk është përfshirë kjo, pse

14 nuk është shkruar kjo në deklaratën tuaj?

15 Pë. Cilën mundësi thua? Unë e kam -- dikund e kam cekë që unë

16 e kam këqyrë këto. Aty shkrun dikund që kam lexue.

17 Py. A ua bëtë të ditur sesa dokumente keni shqyrtuar kur jua

18 morën këtë deklaratë?

19 Pë. S'e kam shqyrtuar, vetëm i kam këqyrë kështu

20 sipërfaqësisht se me lexue aty-këtu ka pak i kam lexu edhe

21 s'mu kanë duk disa relevante dhe i kam lanë krejt.

22 Py. Zoti Gashi, nuk ishte kjo pyetje. Pyetja është: A ja keni

23 bërë të ditur sesa dokumente keni parë, i patë kur e dhatë

24 deklaratën?

25 Pë. Po ka pasë mundësi që i kam shiku. Po unë po them, ka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 39

1 mundësi edhe veç i kam kalu kështu. Përafërsisht i kam këqyrë.

2 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund të na  
3 ndihmojë Trupi Gjykues që të marrim një përgjigje për pyetjen  
4 time?

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti  
6 Gashi, duhet t'i përgjigjeni pyetjes siç ju bëhet. Tani pyetja  
7 është kjo: A u a keni treguar sesa dokumente i patë kur i keni  
8 dhënë deklaratën? Pra, kur keni dhënë deklaratën, u thatë se  
9 numrin e dokumenteve që i patë, materialeve që i patë?

10 DËSHMITARI: Unë thashë nja 70 me i shfletue. Po tash unë  
11 ka mundësi që dhe i kam lexu dhe me sy i kam kalu ashtu.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pyetja  
13 është kjo. A e treguat sesa dokumente i keni parë ditën kur e  
14 dhatë këtë deklaratë?

15 DËSHMITARI: Unë e thashë 60, 70 përafërsisht unë s'kam  
16 mujt...

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Dhe këtë  
18 60-70 e thatë në ditën kur e dhatë këtë deklaratë?

19 DËSHMITARI: Mos a kanë fillimisht? E para mos a kanë?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti  
21 Bowden, ju lutem a mundeni ta udhëzoni klientin që t'i  
22 përgjigjes pyetjes?

23 Z. BOWDEN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, do të doja të  
24 thosha edhe këtë. Paragrafi 14 sigurisht nuk është sot në  
25 mëngjes. Dhe përmbajtja e paragrafit 14, nëse është apo jo ajo

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 40

1 që kërkohet mbase mund t'i kujtonte zotit Gashi rrethanat,  
2 lidhur me paragrafi 14.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në fillim  
4 duhet të marrim përgjigje prej tij për këtë pyetje. Pastaj po  
5 të doni mund të sqaroni?

6 Z. BOWDEN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, atij po i  
7 kërkohet që - më falni - atij po i bëhet pyetje lidhur me  
8 përmbajtjen e deklaratës që u ka dhënë përfaqësuesve të tij,  
9 pra, përmbajtjen e deklaratës, sigurisht, po kjo nuk është në  
10 mënyrë specifike e përmendur në paragrafin 14.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] 14-a nuk u  
12 përjashtua nga leximi sot?

13 Z. HALLING: [Përkthim] U përjashtua. Në fakt, në këtë  
14 paragraf nuk kishte një shifër, një numër.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kështu e  
16 kuptoj edhe unë.

17 Z. BOWDEN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne po hyjmë  
18 tani tek diskutimi i fjalës disa kështu që...

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po.

20 Zoti Gashi, ju lutem të më jepni një përgjigje, ditën kur  
21 ia keni dhënë deklaratën Mbrojtjes, a u thatë atyre që morën  
22 deklaratën që keni lexuar 70 deri në 100 faqe?

23 DËSHMITARI: S'besoj. S'ma merr mendja që kam thënë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

25 Faleminderit, kaq.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 41

1 Mund të vazhdoni, zoti Prokuror.

2 Z. BOWDEN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, është ora 11 pa  
3 tre minuta, mendoj se ky është momenti i duhur për të bërë  
4 pushimin në funksion të pyetjeve tona.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Edhe sa  
6 minuta ju mbeten?

7 Z. BOWDEN: [Përkthim] Mendoj se gjysmën në orën e parë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E  
9 ndërpresim këtu seancën. Do të rikthehemi në orën 11.30  
10 minuta.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
12 shoqërojeni dëshmitarin të dali nga sallë.

13 [Dëshmitar përfundon dëshminë]

14 --- Pauza fillon në orën 10.58

15 --- Seanca rifillon në orën 11.30

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti  
17 Halling, mund të vazhdoni.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Ju kërkoj që të sillet dëshmitari  
19 në sallë.

20 [Dëshmitari vijon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Dëgjoni,  
22 zoti Gashi?

23 Zoti Halling, mund të vazhdoni.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

25 Py. Zoti Gashi, tani dëshiroj që të kalojmë më datën 8

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 42

1 shtator 2020. Është e nesërmja e ditës kur sollën paketën e  
2 parë me materiale në OVL UÇK. Në deklaratë keni thënë se ishit  
3 në zyrë dhe aty ishte dhe ZPS-ja dhe po flisnit me këtë  
4 suedezin nga ZPS-ja. Pse kishte ardhur ZPS-ja në zyrën tuaj  
5 atë ditë?

6 Pë. [E padëgjueshme].

7 PËRKTHYESI: Ndizeni mikrofonin, ju lutem.

8 DËSHMITARI: Më fal.

9 Z. HALLING: [Përkthim]

10 Py. Përsëriteni dhe njëherë përgjigjen, ju lutem.

11 Pë. Derisa përkthyesit na lajmërun, atëherë e kuptum.

12 Py. ZPS-ja u kthye që të merrte dokumentet që kishin ardhur  
13 më datë 7; pra, kështu është?

14 Pë. Po.

15 Py. Dhe erdhën me një urdhër gjykate për këtë qëllim; a nuk  
16 është kështu?

17 Pë. Po. Më vonë.

18 Py. Dhe për një farë kohe, dokumentet nuk ua dhatë atyre  
19 sepse donit t'ia jepnit prokurorit kosovar; kështu?

20 Pë. E vërtetë.

21 Py. Dhe ZPS-ja u përgjigj sipas paragrafit 20 të deklaratës  
22 suaj që: "Mund të rrimë këtu një muaj por askush nga  
23 Prokuroria e Kosovës apo nga policia nuk do të vijë pa  
24 aprovimin tonë; kështu?

25 Pë. E vërtetë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 43

1 Py. Në momentin kur është bërë ky diskutim pati një lloj  
2 konflikti aty për këto dokumente, domethënë, në kuptimin që ju  
3 nuk donit t'ia jepnit dokumentet ZPS-së; kështu?

4 Pë. Donim të jetë edhe Prokuroria e Kosovës aty për këtë.

5 Py. ZPS-ja, në ndonjë moment gjatë këtij diskutimi, a tha që  
6 OVL UÇK-ja mund t'i mbante dokumentet?

7 Pë. Jo. Ajo tha mund me i mbajte, se ata ishin vërtetë hetues  
8 s'kishin ça me mba dhe tha bukfalisht kështu tha "Na" tha "ju  
9 tha munda me thirre" tha "Prokurorinë e Kosovës po ajo pa ja  
10 dhënë na lejen një muj ditë edhe nëse është nevoja nuk ka  
11 mundësi" tha "me ardhë këtu dhe me i marrë pa ja dhënë lejen  
12 na".

13 Py. Dhe ZPS-ja nuk u largua atë ditë deri në momentin që i  
14 mori dokumentet prej jush; kështu?

15 Pë. E vërtetë.

16 Py. Dhe kur erdhën paketat e tjera më datë 16 dhe 22 shtator  
17 ZPS-ja, po kështu, erdhi dhe i mori këto dokumente; kështu?

18 Pë. Po.

19 Py. Zoti Gashi, gjatë kësaj jave a keni parë ndonjë prej  
20 dëshmive që kanë dhënë dëshmitarët e tjerë në këtë çështje  
21 gjyqësore?

22 Pë. Këtu the e kanë dhënë?

23 Py. Pra, këtë javë dëshmitarë të tjerë kanë dhënë dëshmi. Ju  
24 e keni përcjellë këtë dëshmi në video?

25 Pë. Televizor nuk kem ku jep ato. Na një pjesë të shkurtër që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 44

1 më ik e kam përcjellë te telefoni, ka pasë mundësi.

2 Py. Ju thoni ndonjë pjesë të shkurtër aty këtu në telefon, do  
3 të thotë që seancat gjyqësore i keni përcjellë në telefon këtë  
4 javë?

5 Pë. Jo, krejt. Afërsisht, pjesë të shkurtra. S'muj me të  
6 thënë sa.

7 Py. A jeni në dijeni që gjatë kësaj jave ka pasur -- është  
8 dhënë dëshmi këtu lidhur me kohëzgjatjen gjatë së cilës  
9 paketat me materiale janë këqyrur nga OVL UÇK-ja përpara  
10 konferencave për shtyp?

11 Pë. A bën edhe njëherë pyetjen, më fal.

12 Pë. Patjetër. A jeni ju në dijeni se gjatë kësaj jave këtu  
13 është dhënë dëshmi në sallë lidhur me kohëzgjatjen e këqyrjes  
14 së paketave të materialeve në OVL përpara konferencave për  
15 shtyp?

16 Pë. Jo, jo. Unë s'e kam -- shumë sekuenca të shkurtra s'kam  
17 pasë -- jo, nuk kam pa.

18 Py. Kohët e fundit keni bërë takim me shumë prej dëshmitarëve  
19 të Mbrojtjes që kanë dhënë dëshmi lidhur me këtë çështje;  
20 kështu?

21 Pë. Po.

22 Py. A nuk është e vërtetë që ju veten e konsideroni  
23 mbështetës të të akuzuarve në çështje gjyqësore?

24 Pë. Mendon për këta dy?

25 Py. Po.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 45

1 Pë. E mbështes.

2 Py. Prandaj jeni edhe këtu sot, për të mbështetur të  
3 akuzuarit --

4 Pë. Po.

5 Py. -- në këtë çështje gjyqësore?

6 Këto tre paketa që i kanë shkuar Organizatës së  
7 Veteranëve të Luftës, ju dëshironit që të jepeshin shtypit apo  
8 jo?

9 Pë. Po.

10 Py. Sepse dëshironit që të cenonit Dhomat e Specializuara të  
11 Kosovës; kështu?

12 Pë. Jo me i cenu, po kam dashtë me qitë në dritë atë  
13 bashkëpunimin e Dhomave të Specializuara dhe regjimit të  
14 Serbisë. Bashkëpunimin mes Dhomave të Specializuar të Kosovës  
15 dhe të Serbisë.

16 Py. Zoti Gashi, ju lutem edhe njëherë. Pyetja është:  
17 Dëshironit që t'i minonit Dhomat e Specializuara të Kosovës;  
18 kështu?

19 Pë. Unë e thashë mendimin tim.

20 Py. Ju lutem, mund t'i përgjigjeni kësaj pyetje me "po" apo  
21 me "jo"?

22 Donit t'i komprometonit apo minonit Dhomat e  
23 Specializuara të Kosovës?

24 Pë. Ne vetëm të drejtën kemi dashtë me kallëzu q'ashtu.

25 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund t'i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 46

1 kërkon që të bëhet pyetje?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti

3 Gashi, është një pyetje që kërkon ose po ose jo. Mund të  
4 përdorni ose jo-në ose po-në. Dëshironi t'jua përsërisim edhe  
5 njëherë pyetjen?

6 Zoti Halling, bëheni dhe njëherë pyetjen.

7 Z. HALLING: [Përkthim]

8 Py. Dëshironit të minonit punën e Dhomave të Specializuara të  
9 Kosovës; a nuk është kështu?

10 Pë. Ne nuk kemi dëshirë, po ju vetë i keni minuar e si keni  
11 marrë materialet prej Serbie. Kjo s'ki çka me fol këtu.

12 Materialet me prurje na jua. Po ne s'e -- e s'po mos ardhë aty  
13 jo. Unë s'i kam prurje ato atje.

14 Py. Zoti Gashi, keni thënë këtë në paragrafin 15 të  
15 deklaratës tuaj:

16 "Menduar që publiku kosovar duhet të informohet lidhur me  
17 përmbajtjen e paketës meqenëse kjo do t'i minonte Dhomat e  
18 Specializuara të Kosovës, i cili është organ që nuk e njohim  
19 si legjitim".

20 Ju këtë mendoni akoma? Kështu e mendoni vazhdoni ta  
21 mendoni kështu?

22 Pë. Po, e mendoj.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kam pyetje tjera.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

25 Faleminderit, zoti Halling.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese nga z. Bowden

Faqe 47

1 Keni ndonjë pyetje plotësuese, zoti Bowden?

2 Z. BOWDEN: [Përkthim] Kam dy pyetje të cilat dalin nga  
3 kundërpvetjet e bëra nga Prokuroria.

4 Pyetje vijuese nga zoti Bowden:

5 Py. Kanë të bëjnë, zoti Gashi, dëshminë që keni dhënë për  
6 datën 7 shtator dhe 16 shtator.

7 A kam të drejtë nëse them se ka dy periudha kohore në të  
8 dyja këto ditë --

9 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kjo pyetje nuk  
10 është e saktë.

11 Z. BOWDEN: [Përkthim] Nuk kam mbaruar akoma. Vazhdon  
12 pyetja.

13 Py. Periudha e parë është periudha totale e kohës midis  
14 momentit kur mbërriti paketa në zyrat e OVL-së deri në  
15 thirrjen e konferencës për shtyp. Pra, kjo është periudha e  
16 parë kohore; kështu?

17 Pra, fillon nga momenti kur erdhën dokumentet dhe vazhdon  
18 deri në thirrjen e konferencës për shtyp. Dhe kjo është një  
19 periudhë kohore e cila qartësisht dihet sesa është; kështu?

20 Pë. Po.

21 Py. Pastaj ka një periudhë tjetër kohore që, në fakt, është  
22 periudha gjatë së cilës faktikisht ju keni këqyrur dokumentet?

23 Pë. E vërtetë.

24 Py. Dhe këto dy periudha të ndryshme kohore nuk janë e njëjta  
25 nuk përkojnë --

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Çelë Gashi (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese nga z. Bowden

Faqe 48

1 Pë. Jo.

2 Py. -- në kohëzgjatje.

3 Dhe këtë dëshironi dhe të thoni dhe këtu?

4 Pë. Po.

5 Z. BOWDEN: [Përkthim] S'kam gjë tjetër për të shtuar, të  
6 nderuar Gjykatës.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

8 Faleminderit.

9 Zoti Worboys, s'keni ndonjë gjë për të shtuar?

10 Z. WORBOYS: [Përkthim] Më duket se jo, po nuk e di ç'më  
11 thotë zoti Haradinaj? A jo në rregull.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Dëshironi  
13 që t'i afroheni klientit për të marrë udhëzime.

14 Z. WORBOYS: [Përkthim] Jo, i mora. I mora. Jam në  
15 rregull.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

17 Prokuroria.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Asgjë më shumë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Nuk e di anëtarët e Trupit Gjykses nëse kanë.

22 Zoti Gashi, këtu mbyllet dëshmia juaj. Mund të largoheni  
23 tani. Ju falënderoj për praninë tuaj këtu.

24 [Dëshmitari largohet]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në

1 rregull. Lidhur me marrjen në pyetje të dëshmitarëve nga zoti  
2 Rees, Trupi Gjykues ka vendosur si më poshtë.

3 Trupi Gjykues e miraton kërkesën e Mbrojtjes së zotit  
4 Gucati për të rithirrur këta dëshmitarë.

5 Trupi Gjykues ka vendosur, në bazë të këtyre arsyeve,  
6 nxjerrja me vonesë e materialeve ka të bëjë me faktin se  
7 Prokuroria i ka nxjerrë këto Mbrojtjes me vonesë dhe i ka  
8 kërkuar Trupit Gjykues urdhër që të mos nxjerrë.

9 Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren argumentin e ZPS-së mbi  
10 efektin që kanë te pretendimet për shtyrjen në kryerjen e  
11 krimit - më falni, nuk është kjo - Trupi Gjykues e ka shtyrë  
12 marrjen e vendimit ndër të tjera dhe për materialet 191 dhe  
13 195 deri në 200 deri në përfundim të paraqitjes së provave nga  
14 ZPS-ja. Për këtë arsye materialet që janë urdhëruar të nxirren  
15 i kanë shkuar Mbrojtjes pas mbylljes së paraqitjes së provave  
16 nga Prokuroria dhe nuk e ndihmonin Mbrojtjen në momentin kur  
17 Mbrojtja i ka bërë kundërpyetje dëshmitarëve.

18 Trupi Gjykues vëren argumentin e ZPS-së mbi efektet që ka  
19 te pretendimet për shtytje të krimit. Megjithatë, Trupi  
20 Gjykues mban parasysh se këta dëshmitarë po thirren pasi ka  
21 përfunduar paraqitja e provave të ZPS-së në përputhje me  
22 premtimet të Trupit Gjykues për ta përmbushur një kërkesë të  
23 tillë.

24 ZPS-ja mban qëndrimin se nuk ekziston asnjë bazë për t'i  
25 kthyer asnjë aspekti për të cilin kanë dëshmuar më parë këta

1 dëshmitarë. Dhe informacioni për materiale të rregulli 102(3)  
2 janë teje delikate dhe rrezikojnë të komprometojnë betimet e  
3 tanishme të ZPS-së.

4 Përpara këtë arsye Trupi Gjykues urdhëron Mbrojtjen t'i  
5 bëje pyetjet me këto kufizime. Nuk lejohen pyetje për asnjë  
6 temë tjetër veç materialeve të nxjerra në përputhje me  
7 vendimet F413 dhe F435. Megjithëse Mbrojtja nuk është e  
8 detyruar të japë paraprakisht një përmbledhje të pyetjeve të  
9 synuara të bëhet e ditur nga ana e Mbrojtjes paraprakisht  
10 lidhja me çështjen e informacionit përpara se të bëjnë  
11 pyetjet, pra, që kanë të bëjnë me këto dokumente.

12 Për arsye sigurie, në përputhje me rregulli 120, Mbrojtja  
13 udhëzohet që kundërpyetjet t'i bëjë në seancë private. Trupi  
14 Gjykues do ta shqyrtojë transkriptin dhe do të urdhërojë  
15 klasifikimin nëse është e nevojshme.

16 Duke dhënë -- duke pasur parasysh që dy dëshmitarët janë  
17 në dispozicion për t'u dëgjuar javën e ardhshme nga e mërkura  
18 deri të premtën, Trupi Gjykues pret që ata të jenë të gatshëm  
19 për t'u dëgjuar ditën e mërkurë në datë 15 dhjetor paradite. I  
20 kërkohet Mbrojtjes që t'i japë Trupit Gjykues dhe ZPS-së një  
21 vlerësim kohëzgjatjes së nevojshme që mendon për kundërpyetjet  
22 për secilin dëshmitar brenda datës 13 dhjetor 2021, brenda  
23 orës 16.00.

24 Këtu mbyllet urdhri i dhënë gojarisht.

25 Zoti Rees, mund ta jepni këtë vlerësim sot apo referoni

1 të përdorni afatin?

2 Z. REES: [Përkthim] Unë mund ta them që tani që nuk  
3 parashikojmë që kundërpyetjet të zgjasin më shumë se një  
4 gjysëm ore.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]  
6 Faleminderit.

7 Tani kam dhe disa çështje administrative.

8 Zoti Rees, Zyra Administrative na ka informuar se  
9 dëshmitari tjetër, zoti Fazlliu, nuk ka mbërritur ende në Hagë  
10 dhe nuk është i disponueshëm për të dëshmuar sot. Dëshirojmë,  
11 do të donim që ta fillonim dhe ta përfundonim dëshminë e tij  
12 ditën e mërkurë. Mund të jepni ndonjë informacion lidhur me  
13 këtë?

14 Z. REES: [Përkthim] Mund të jap këtë informacion. Pjesën  
15 më të madhe të provave nga ana e Mbrojtjes i kemi paraqitur.  
16 Tani ndodhemi në një moment ku ne do të rishikojmë se deri ku  
17 do të jetë e nevojshme për të dëgjuar dëshmitë e tjera, sa i  
18 takon dëshmitarëve flas. Do t'i japim informacion të  
19 përditësuar Trupit Gjykses me të marrë një vendim për këtë. Ka  
20 çështje të tjera administrative të cilat do të donim që të  
21 diskutonim përpara se të ishim në gjendje që ta mbyllnim  
22 zyrtarisht paraqitjen e provave nga ana jonë, sidomos sa i  
23 takon dy dëshmitarëve që janë rithirrur. Po kështu do të ketë  
24 një kërkesë për pranimin e materialeve jo përmes dëshmitarëve  
25 dhe për çështje të tjera të lidhura, i cili do të parashtrohet

1 në përputhje me urdhrin sot. Gjithashtu parashikojmë që të  
2 kërkojmë të pajtohemi për disa fakte lidhur me ZPS-në përpara  
3 se ta mbyllim zyrtarisht paraqitjen e provave nga ana jonë.

4 Sigurisht synojmë ta bëjmë këtë javën tjetër. Nëse nuk do  
5 të kemi mundësi, atëherë do t'i drejtohemi Trupit Gjykues në  
6 momentin e duhur. Por jemi të vetëdijsëm se duhet ecur  
7 përpara edhe me paraqitjen e provave nga Mbrojtja e zotit  
8 Haradinaj dhe Trupi Gjykues ka urdhëruar fillimin e paraqitjes  
9 së provave nga zoti Haradinaj javën e ardhshme. Kështu që, ne  
10 nuk parashikojmë ndonjë gjë që ta pengojë fillimin e  
11 paraqitjes së provave nga Mbrojtja e Haradinajt javën e  
12 ardhshme.

13 Sa i takon çështjeve dhe sidomos dëshmitareve të  
14 përmendur, dëshmitarit - më falni - të përmendur, ne po  
15 rishikojmë çështjen tonë dhe mundet që të mos ketë nevojë për  
16 dëshmitarë të tjerë dhe mund të mbyllet vetëm me kundërpjetet  
17 që do t'i bëjmë zonjës Pumper dhe zotit Jukiç të mërkurën  
18 paradite.

19 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Rees,  
21 dëshirojmë që më paraprakisht të na informoni për dëshmitarin  
22 e fundit. Mbase brenda ditës së martë?

23 Z. REES: [Përkthim] Patjetër.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Së dyti,  
25 dëshiroj që të mund ta mbyllni paraqitjen e provave tuaja në

1 përfundim të kundërpyetjeve të këtyre dy dëshmitarëve me  
2 përjashtim të faktit që keni edhe një mocion për praninë të  
3 provave në letër, pra, jo përmes dëshmitarëve.

4 Me kusht që ta kemi dhe këtë mocion. Duam që çështja të  
5 ecë në mënyrë që të kalojmë në hapin e ardhshëm që është  
6 paraqitja e provave nga Mbrojtja e Haradinajt. Pasi ta keni  
7 mbyllur ju do të jetë e mundshme kjo? Ose mund të na jepni që  
8 tani mocionin për praninë e provave jo përmes dëshmitarëve,  
9 që të fillojmë ta shqyrtojmë.

10 Z. REES: [Përkthim] E kuptoj shumë mirë qëndrimin tuaj.  
11 Ne do të bëjmë çmos që ta mbyllim sa më shpejt paraqitjen e  
12 provave nga ana jonë.

13 Jemi të vetëdijshëm të faktit që nuk kanë përfunduar --  
14 detyrimi i ZPS-së për të nxjerrë materiale nuk është se  
15 përfundon në një moment të caktuar. Kështu që mbyllja e  
16 procedurës së paraqitjes së provave ka të ngjarë që të ndodhë  
17 pas fundit të javës së ardhshme. Mund të ndodhë që gjatë javës  
18 së ardhshme të kërkojmë leje nga Trupi Gjykses, për shembull,  
19 të lejojë diskutimet e pambyllura ende për faktet për të cilat  
20 palët mund të pajtohen. Një marrëveshje e cila mund të arrihet  
21 në çfarëdo lloj momenti përpara se të mbyllet paraqitja e  
22 provave nga secila palë.

23 Do të doja -- a mund t'i drejtohem Trupit Gjykses në  
24 lidhje me këtë në çdo moment, sa i takon dëshmitarët javën e  
25 ardhshme?

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po. Po  
2 vetëm kimi parasysh që ne duhet që të diskutojmë edhe një farë  
3 afati sa i takon kësaj. Së dyti, nuk kemi zgjidhur dëshmitarin  
4 1248 edhe nëse kjo do të ketë marrëveshje, pra, për faktin së  
5 cilat palët pajtohen.

6 Z. REES: [Përkthim] Sa i takon deklaratës së dëshmitarit,  
7 zoti Bowden dhe provat materiale. Ne do të dorëzojmë këtë sot  
8 pas dreke një mocion për pranimin e provave jo përmes  
9 dëshmitarëve dhe aty do të bëjmë të ditur se kërkojmë që të  
10 pranohen dhe deklarata e tillë e provave materiale përkatëse.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mendoj se  
12 Prokuroria ende nuk ka asnjë kundërshtim për këtë.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo është e saktë, i nderur  
14 Gjykatës.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]  
16 Faleminderit.

17 Keni ndonjë kundërshtim lidhur me atë që tha zoti Rees?

18 Z. WORBOYS: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti Rees,  
20 në qoftë se dëshironi mund të dorëzoni dëshminë e zotit  
21 Bowden, nuk ka ndonjë kundërshtim për momentin.

22 Z. REES: [Përkthim] E ofrova atë, deklaratën dhe provat  
23 materiale, pra, deklaratën që ka dhënë ai.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në  
25 rregull. Ju lutem, a mund të na jepni një numër për këtë

1 provat materiale dhe për deklaratën që sapo u përmend.

2 Z. REES: [Përkthim]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Jo, po  
4 komunikoj me sekretaren e seancës.

5 [Anëtarët e Trupit Gjykes dhe Sekretarja e  
6 seancës këshillohen]

7 Z. REES: [Përkthim] Në fakt drafti, versioni në draft  
8 ndoshta nuk është i saktë, kështu që, nuk ju ndihmoj dot për  
9 momentin.

10 Deklarata është DHG0447-DHG0449. Provat materiale të  
11 përmendura në të janë DHG0392-DHG0404, DHG0444-DHG0446,  
12 DHG0431-DHG0443, DHG0405 DHG0418, DHG0419-DHG0430, DHG0390-  
13 DHG0391, DHG0388-DHG0389 dhe DHG0364-DHG0387.

14 Mbase mund të ketë kuptim që të jepet një numër P edhe  
15 për deklaratën edhe për provat materiale. Duket sikur  
16 Sekretarja po aprovon me kokë. Do t'ia lë në dorë Sekretares  
17 sa i takon aspekteve teknike.

18 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
19 dokumentet sipas rendit të lexuar nga zoti Rees, DHG0447-  
20 DHG0449 do të shënjojnë si prova materiale 1D10; DHG0392-  
21 DHG0404 do të jenë prova materiale 1D11; DHG0444-DHG0446 do të  
22 jenë prova materiale 1D12; DHG0431-DHG0443 do të jenë prova  
23 materiale 1D13; DHG0405-DHG0418 do të jenë prova materiale  
24 1D14; DHG0419-DHG0430 do të jenë prova materiale 1D15;  
25 DHG0390-DHG0391 do të jenë prova materiale 1D16; DHG0388-

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 56

1 DHG0389 do të jenë prova materiale 1D17 dhe DHG0364-DHG0387 do  
2 të jenë prova materiale 1D18.

3 Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pra,  
5 provat materiale nga 1D10 deri në 1D18 pranohen sipas  
6 rregullit 153 pas përmbushjes së kushteve të parashikuara në  
7 rregullin 138 për pranueshmërinë. Faleminderit, i nderuar zoti  
8 Rees.

9 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Tani të  
11 kalojmë tek avokati i zotit Haradinaj.

12 Për procesverbal Trupi Gjykses riklasifikoi shtojcën  
13 konfidenciale 2 të F417, që është përmbledhja e dëshmisë së  
14 zotit Haradinaj.

15 Zoti Worboys, ekipi juaj dorëzoi një përmbledhje të  
16 provës së klientit më datë 3 dhjetor. Në atë kohë zoti Cadman,  
17 i tha Panelit që dokumenti thjesht ishte dorëzuar si një  
18 dokument i përmbledhur sepse zoti Haradinaj ishte ende në  
19 karantinë dhe nuk kishte mundësi që të nënshkruante  
20 dokumentin.

21 A e keni si synim që të dorëzoni dokumentin e nënshkruar  
22 përderisa sa zoti Haradinaj është i pranishëm këtu në gjyq?

23 Z. WORBOYS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, faleminderit  
24 që e ngritët këtë çështje. Pozicioni im është që unë nuk kam  
25 kontaktuar shumë me zotin Cadman që 48 orëve të fundit sepse

1 nuk është mirë fare. Dhe do thosha që është -- unë do të  
2 mundohem që të jap një përgjigje deri të hënën, për  
3 Prokurorinë dhe do të mundohem që këtë çështje ta trajtoj  
4 gjatë fundjavës.

5 Ju kërkoj shumë ndjesë, po ky është pozicioni im për  
6 momentin por do ta vlerësoja shumë në qoftë se kjo do të ishte  
7 në rregull me ju. Domethënë, ju kërkoj ndjesë për këtë njoftim  
8 të momentit të fundit, megjithatë, ne po mundohemi që të ecim  
9 përpara në mënyrën më të mirë të mundshme.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ndërkohë  
11 që jemi me këtë çështje do të ishte mirë të hënën që të na  
12 thonit në qoftë se zoti Haradinaj synon që të japë dëshmi si  
13 dëshmitar sipas rregullit 154 apo jo. Jam i sigurtë që  
14 Prokuroria dhe zoti Rees do ta vlerësonin që ta dinin këtë  
15 informacion, të kishin një përgjigje lidhur me këtë.

16 Z. WORBOYS: [Përkthim] E kuptuam, të nderuar Gjykatës.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Le të  
18 themi të hënën deri në drekë duhet të kemi një përgjigje për  
19 këtë.

20 Z. WORBOYS: [Përkthim] Do t'ju tregojmë, do t'ju themi se  
21 cili është pozicioni deri në mesditën e ditës së hënë. Ne e  
22 kemi diskutuar këtë gjë sa i takon pozicionit nën rregullin  
23 154.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E keni  
25 diskutuar, po nuk keni vendosur.

1 Z. WORBOYS: [Përkthim] Jo, thjeshtë e kemi ngritur si  
2 çështje dhe nuk është se e kemi një përgjigje.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Dhe a keni  
4 një përgjigje për neve se cili nga dy dëshmitarët do të  
5 thirret javën që vjen?

6 Z. WORBOYS: [Përkthim] Po, do jetë dëshmitari 1254.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kaq kishim  
8 për ju zoti Worboys.

9 Z. WORBOYS: [Përkthim] Kemi dhe një tjetër çështje, të  
10 nderuar Gjykatës dhe po e ngre tani duke pasur parasysh faktin  
11 që kam këtë javë që merrem aktivisht me këtë çështje. Sa i  
12 takon shqyrtimit të dëshmitarëve që do të rithirren, unë e  
13 kuptoj që afati është sot që të dorëzohen kërkesat. Neve nuk  
14 planifikojmë që të bëjmë pyetje për pyetjet plotësuese, por  
15 mbështesim pozicionin e Mbrojtjes së zotit Gucati. Kërkoj të  
16 di, në qoftë se mund të bëj një aplikim formal për këtë apo në  
17 qoftë se më duhet ta trajtoj këtë gojarisht aktualisht.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në qoftë  
19 se doni mund të na thoni dhe gojarisht.

20 Z. WORBOYS: [Përkthim] Mirë atëherë, në atë rast, ne do  
21 të donim që të kishim leje që të bënim pyetje plotësuese, pra,  
22 për dëshmitarët. Në qoftë se nuk do të kemi pyetje për të bërë  
23 atëherë mund të themi që jemi në mbështetje të pozicionit të  
24 Mbrojtjes së zotit Gucati.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A keni

1 ndonjë problem lidhur me këtë gjë, zoti Halling?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi ndonjë problem me këtë,  
3 të nderuar Gjykatës. E vetmja gjë është që e kuptojmë  
4 vështirësitë që ka pasur Mbrojtja e zotit Haradinaj kohët e  
5 fundit, por duam të themi që deklarata për përgatitjet është  
6 vonë. Kështu që do ta vlerësonim në qoftë se deklarata do të  
7 mund të na ofrohet neve të mërkurën që vjen maksimumi.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Është  
9 kërkesë e arsyeshme.

10 Z. WORBOYS: [Përkthim] Po. E kuptoj këtë gjë dhe kjo  
11 është një reflektim i diskutimeve që kam pasur edhe me ZPS-në.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e  
13 zotit Haradinaj, nuk e di në qoftë se do jetë në gjendje që të  
14 ofrohet deklarata e hapjes më datë 15 dhjetor. Nuk e dimë në  
15 këtë pikë, por gjithsesi, në qoftë se do të ndodhë kjo gjë,  
16 atëherë do të vazhdojmë me pjesën e provave materiale më datë  
17 16 dhjetor.

18 Në qoftë se dëshmitarët të mërkurën do të zënë të dy  
19 sesionet e paradites, atëherë Mbrojtja planifikon që deklarata  
20 e zotit Haradinaj të jepet të enjten në mëngjes. Është kështu?

21 Z. WORBOYS: [Përkthim] Të nderuar, e kuptojmë plotësisht.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]  
23 Faleminderit.

24 Kemi përfunduar këtu. Ka qenë një javë e gjatë dhe mendoj  
25 që kemi realizuar goxha gjëra sot. Faleminderit për

1 bashkëpunimin.

2 Faleminderit përkthyesve. Faleminderit stafit  
3 administrativ. Dhe faleminderit gjithashtu edhe stafit të  
4 sigurisë për të gjithë mbështetjen tuaj.

5 Do të shihemi sërish të enjten në orën 9.30.

6 --- Seanca mbyllet në orën 12.06

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25